REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË**

*Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

*Dokument parlamentar*

*Tiranë më 17 .02. 2021*

# RAPORT

## MBI SHQYRTIMIN E KANDIDATURAVE PËR POZICIONIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, si pasojë e dorëheqjes së z. Helidon Bushati, njoftuar në Kuvend nëpërmjet shkresës 461/1, datë 22.12.2020, të Autoritetit të Konkurrencës dhe pas publikimit në faqen e Kuvendit të kësaj vakance vendosur me vendimin nr. 1/2021 të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 21, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" të ndryshuar, në mbledhjen e datës 17.02.2021 zhvilloi seancë dëgjimore me kandidaturat e vetëofruara për plotësimin e kësaj vakance.

Në përfundim të afatit të përcaktuar, datë 12.02.2021, u depozituan në Kuvend tre kandidatura:

1. **Znj. Zhaklina Peto**
2. **Z. Denar Biba**
3. **Z. Pajtim Melani**

Mbledhja e zhvilluar *online,* u drejtua nga Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, z. Anastas Angjeli.

Në dëgjesë morën pjesë vetëm dy prej kandidatëve, pasi znj. Zhaklina Peto nuk u paraqit.

Gjithashtu mbledhjen e ndoqën dhe morrën pjesë online kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, z. Taulant Balla, kryetari i Grupit Parlamentar "Demokrat", z. Myslim Murrizi, kryetari i Grupit Parlamentar "Demokraci dhe drejtësi", z. Edmond Stojku, kryetari i Grupit Parlamentar "I pavarur", z.Nimet Musaj dhe deputetë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Kandidatët z. Denar Biba dhe z. Pajtim Melani paraqitën një përshkrim të shkurtër të eksperiencave të tyre të punës, veçanërisht në lidhje me fushën e zbatimit të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" të ndryshuar, dhe paraqitën vizionin e tyre mbi kontributin konkret në zhvillimin e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës në përmbushje të misionit të tij për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit.
Gjithashtu kandidatët iu përgjigjen edhe pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të kritereve ligjore, meritës, eksperiencës profesionale si dhe nivelit të prezantimit në seancën dëgjimore, Komisioni vlerësoi se z. Denar Biba i plotësonte kriteret ligjore sipas nenit 20, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar, ndërsa z. Pajtim Melani u përjashtua pasi nuk plotësonte kriteret sipas gërmës c) të nenit 20, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar.

Në përfundim, bazuar në nenin e 111, të Rregullores së Kuvendit, sipas të cilit *të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, që do të mbështesin për t'ia propozuar Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit,* Komisioni i përcjell grupeve parlamentare të Kuvendit raportin bashkë me vlerësimin për kandidaturat për vijimin e procedurave.

**KRYETAR**

**ANASTAS ANGJELI**